



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.170

20 dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.915, datë 17.11.2010	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të kontratës së lidhur për procedurat e prokurimit, të kryera nga Instituti i Statistikave, si autoritet kontraktor 8735
Vendim i KM nr.916, datë 19.11.2010	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit publik, për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, si autoritet kontraktor..... 8735
Vendim i KM nr.917, datë 17.11.2010	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës 8736
Vendim i KM nr.918, datë 17.11.2010	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit publik për zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, si autoritet kontraktor 8736
Vendim i KM nr.919, datë 17.11.2010	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Gjykata e Lartë, si autoritet kontraktor 8737
Vendim i KM nr.920, datë 17.11.2010	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurën e prokurimit, me objekt “Shërbimi me rojë civile”, të kryer nga Muzeu Historik Kombëtar, si autoritet kontraktor..... 8737
Vendim i KM nr.923, datë 10.11.2010	Për një shtesë në vendimin nr.48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë në vështirësi”, të ndryshuar 8738
Vendim i KM nr.928, datë 17.11.2010	Për një shtesë në vendimin nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2010, në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar 8738

Vendim i KM nr.930, datë 17.11.2010	Për miratimin, në parim, të protokollit të privilegjeve dhe imuniteteve, të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore.....	8739
Vendim i KM nr.931, datë 17.11.2010	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike e të shërbimit.....	8747
Vendim i KM nr.932, datë 17.11.2010	Për miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e garantimit të rregullit dhe të sigurisë në gjykata”	8749
Vendim i KM nr.934, datë 17.11.2010	Për miratimin, në parim, të Konventës së Këshillit të Europës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”.....	8753
Vendim i KM nr.935, datë 17.11.2010	Për miratimin, në parim, të Konventës së Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martese”.....	8760
Vendim i KM nr.936, datë 17.11.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifat e shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010 - 2011”	8764
Vendim i KM nr.937, datë 17.11.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë””	8771

VENDIM
Nr.915, datë 17.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR
PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA INSTITUTI I STATISTIKAVE,
SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/c të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Institutit të Statistikave (INSTAT), si autoritet kontraktor, të përfundojë procedurat e prokurimit me objekt “Materiale për regjistrimin” dhe “Publikime për njësinë e regjistrimit”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2010, si dhe të nënshkruajë kontratën me ofertuesit fitues brenda datës 30 dhjetor 2010.

2. Ngarkohen Instituti i Statistikave, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.916, datë 19.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK, PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/c të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, si autoritet kontraktor, të përfundojë procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i kabinës elektrike, vila nr.1, Vlorë”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.917, datë 17.11.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 27.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve në buxhetin e miratuar për vitin 2010, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim” të shtohet fondi prej 4 602 625 (katër milionë e gjashtëqind e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekësh, përkatësisht, në zërin “Paga”, në shumën 2 402 625 (dy milionë e katërqind e dy mijë e gjashtëqind e njëzet e pesë) lekë, dhe në zërin “Investime kapitale të brendshme”, në shumën 2 200 000 (dy milionë e dyqind mijë) lekë.

b) Në programin “Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastrukturën e cilësisë dhe pronësinë industriale”, për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, të shtohet fondi 1 147 515 (një milion e njëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, i ndarë, përkatësisht, 1 097 375 (një milion e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë, në zërin “Paga”, dhe 50 140 (pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet) lekë, në zërin “Sigurime shoqërore”.

c) Këto shtesa të përballohen nga pakësimet e fondeve në programin “Mbështetje për zhvillim ekonomik”, në vlerën 4 750 140 (katër milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet) lekë, përkatësisht, për Qendrën Kombëtare të Licencimit, në vlerën 3 550 140 (tre milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet) lekë, nga të cilat, në zërin “Paga”, për 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë, dhe në zërin “Sigurime shoqërore”, për 50 140 (pesëdhjetë mijë e njëqind e dyzet) lekë, si dhe për Albinvest, në zërin “Investime kapitale të brendshme”, në masën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë, gjithashtu, nga pakësimi në programin “Mbështetje për burimet natyrore”, për RISHM-në, në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.918, datë 17.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT
PUBLIK PËR ZYRËN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM, SI AUTORITET
KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/c të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të përfundojë, brenda datës 30 dhjetor 2010, procedurën e prokurimit, me objekt “Blerje pajisjesh kompjuterike”, të ndarë me lote, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2010. Brenda këtij afati përfshihet edhe nënshkrimi i kontratës.

2. Ngarkohen Prokuroria e Përgjithshme, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.919, datë 17.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR,
PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA GJYKATA E LARTË, SI
AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/c të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Gjykatës së Lartë të përfundojë, brenda datës 30 dhjetor 2010, procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i mjediseve në Gjykatën e Lartë”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2010, si dhe të nënshkruajë kontratën me ofertuesit fitues.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Gjykata e Lartë dhe Agjencia e Prokurimit Publik (APP) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.920, datë 17.11.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME
OBJEKT “SHËRBIMI ME ROJË CIVILE”, TË KRYER NGA MUZEU HISTORIK
KOMBËTAR, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/c të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Muzeut Historik Kombëtar, si autoritet kontraktor, për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 30 nëntor 2010, për procedurën e prokurimit, me objekt “Shërbim me rojë civile”.

2. Ngarkohen Muzeu Historik Kombëtar dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.923, datë 10.11.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.48, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN DHE KRITERET E PËRFITIMIT NGA PROGRAMI I
NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË NË VËSHTIRËSI”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë”, me këtë përmbajtje:

“ë) emigrantët e kthyer me probleme ekonomike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.928, datë 17.11.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.71, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2010, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 2 të vendimit nr.71, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, shtohet paragrafi i mëposhtëm me këtë përmbajtje:

“Për punonjësit e Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, afati i kontratës së punës shtyhet deri më 31 dhjetor 2010.”.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi të përballohen nga të ardhurat e vetë institucionit.

3. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.930, datë 17.11.2010

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË PROTOKOLLIT TË PRIVILEGJEVE DHE
IMUNITETEVE, TË QENDRËS PËR ZBATIMIN E LIGJIT NË EUROPËN JUGLINDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të protokollit të privilegjeve dhe imuniteteve, të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLLI
**MBI PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E QENDRËS PËR ZBATIMIN E LIGJIT NË
EUROPËN JUGLINDORE**

Palët e këtij Protokolli, duke pasur parasysh se Konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore, bërë në Bukuresht, Rumani, më 9 dhjetor 2009, parashikon që shtetet anëtare të lidhin një Protokoll mbi privilegjet dhe imunitetet e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të këtij Protokollit:

- a) “Konventa e SELEC” nënkupton Konventën e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore, bërë në Bukuresht, Rumani, më 9 dhjetor 2009;
- b) “SELEC” nënkupton Qendrën e Zbatimit të Ligjit në Europën Juglindore;
- c) “Vendi pritës” nënkupton vendin ku ndodhet selia e SELEC-it;
- d) “Përfaqësuesit e shteteve anëtare” nënkupton anëtarët e delegacioneve shtetërore që marrin pjesë në mbledhjet e thirrura nga SELEC-i;
- e) “Stafi i SELEC” nënkupton të gjithë personat që punojnë nën drejtimin dhe kontrollin e drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorëve të tjerë;
- f) “Drejtori i përgjithshëm” nënkupton drejtorin e përgjithshëm të SELEC-it;
- g) “Drejtorët” nënkupton drejtorët e tjerë të SELEC-it;
- h) “Koordinatorët” nënkupton punonjësit e emëruar në zyrat e SELEC-it nga shtetet anëtare;
- i) “Mbledhje e thirrur nga SELEC-it” nënkupton çdo mbledhje të çdo organi të SELEC-it ose organi në varësi apo çdo konference e thirrur nga SELEC-i;
- j) “Pronë” nënkupton të gjitha të ardhurat e SELEC-it dhe të gjitha pronat e saj, duke përfshirë fondet, asetet dhe pasuritë e tjera që i takojnë SELEC-it, qoftë ato në pronësi të SELEC-it apo në administrim apo që mbahen nga SELEC-i në përputhje me detyrat zyrtare të kryera nga SELEC-i;
- k) “Ambientet” nënkupton godinat ose pjesë të godinave, duke përfshirë truallin në vartësi të tyre që shfrytëzohen vetëm për qëllim të SELEC-it pavarësisht pronësisë së tyre;
- l) “Arkivat” nënkupton të gjitha dosjet, raportet, korrespondencën, dokumentet, dorëshkrimet, informacione kompjuterike dhe mediatike, fotografi, filma, video, regjistrime zanore dhe çdo të dhënë tjetër që i takon apo mbahet nga SELEC-i.

Neni 2
Zbatimi i Protokollit

SELEC-i do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet përkatëse të Palëve për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë dhe parandalon çdo abuzim me privilegjet dhe imunitetet e dhëna sipas dispozitave të këtij Protokollit.

KREU II
PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E SELEC-IT

Neni 3
Imuniteti ndaj një procesi ligjor

1. SELEC dhe pronat e saj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, gëzojnë imunitet ndaj çdo forme procesi ligjor me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë kur Këshilli, me vendim të tij, autorizon heqjen e këtij imuniteti. Asnjë heqje e tillë e imunitetit nuk do të shtrihet në ndonjë masë ekzekutimi për të cilën do të jetë e nevojshme një heqje e veçantë e imunitetit.

2. Pa cenuar paragrafin e mësipërm, SELEC-i nuk do të gëzojë imunitet në lidhje me:

- a) një padi civile në bazë të një detyrimi kontraktual të SELEC-it;
- b) një kundërpadi të lidhur drejtpërdrejt me procedimet ligjore të filluara nga SELEC-i;

c) një padi civile në lidhje me shkelje të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale që përcaktohen në Konventën e SELEC-it;

d) një padi civile për dëmet e rezultuara nga një aksident i shkaktuar nga një automjet, anije apo avion që i përket ose që operon në emër të SELEC-it kur këto dëme nuk mbulohen nga sigurimet.

Neni 4

Paprekshmëria

1. Ambientet e SELEC-it janë të paprekshme. Pronat e saj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, kanë imunitet nga çdo kontroll, kërkesë, konfiskim, shpronësim apo çdo formë tjetër ndërhyrjeje, qofshin akte ekzekutive, administrative, gjyqësore apo legislative.

2. Arkivat e SELEC-it janë të paprekshme kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen.

Neni 5

Flamuri dhe emblema

SELEC ka të drejtë të ekspozojë flamurin dhe emblemën e saj në ambientet e veta dhe në mjetet e saj të transportit kur përdoren për qëllime zyrtare. Flamujt e vendeve anëtare vendosen në ambientet e SELEC-it.

Neni 6

Lehtësirat dhe imunitetet në lidhje me komunikimet dhe publikimet

1. Palët lejojnë SELEC-in të komunikojë lirisht dhe pa nevojën për të marrë lejë të veçantë për të gjitha qëllimet zyrtare, dhe mbrojnë të drejtat e SELEC-it për të vepruar kështu. SELEC-i ka të drejtë të përdorë sisteme të fshehta, si edhe kode të ndryshme për të dërguar dhe marrë korrespondencat zyrtare dhe komunikimet e tjera zyrtare nëpërmjet korrierëve apo në çanta të vulosura, të cilat u nënshtrohen të njëjtave privilegje dhe imunitete si ato për korrierët dhe çantat diplomatike.

2. SELEC-i për komunikimet e saj zyrtare, gëzon trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga Palët për misionet diplomatike të çdo shteti.

3. Palët njohin të drejtën e SELEC-it për të publikuar brenda territorit të tyre për qëllimet e përcaktuara në Konventën e SELEC-it. Të gjitha komunikimet zyrtare të drejtuara për SELEC-in dhe të gjitha njoftimet zyrtare të jashtme të lëshuara nga SELEC-i, të transmetuara nëpërmjet çdo forme e mjeti janë të paprekshme.

Neni 7

Përfundime

1. Brenda objektit të veprimtarisë së saj zyrtare, SELEC-i dhe pronat e saj përjashtohen nga:

a) të gjitha taksat direkte të vendosura nga autoritetet kombëtare, rajonale apo lokale; por ka një mirëkuptim që SELEC-i nuk do të kërkojë të përjashtohet nga tarifatat, taksat apo pagesat të cilat nuk janë gjë tjetër veç detyrime për shërbimet e ndryshme publike e komunale;

b) taksat doganore, ndalimet apo kufizimet në importin apo eksportin e mallrave për përdorim zyrtar, me kusht që mallrat e importuara të mos shiten apo disponohen ndryshe në territorin e Palës në fjalë, me përjashtimet sipas kushteve të miratuara nga ajo Palë;

c) taksat doganore, ndalimet apo kufizimet për importin apo eksportin e publikimeve për qëllime zyrtare;

d) taksimet indirekte për mallrat dhe shërbimet e siguruar për qëllime zyrtare, duke përfshirë TVSH-në mbi këto mallra dhe shërbime, sipas të njëjtave kushte që aplikohen për misionet diplomatike në territorin e Palës në fjalë.

2. Përfshirjet e parashikuara në paragrafin 1, pika d e këtij neni mund të jepen nëpërmjet një kompensimi sipas procedurave të njëjta që aplikohen për misionet diplomatike në territorin e Palës në fjalë.

Neni 8

Lirimi i aseteve financiare nga kufizimet

Duke mos qenë objekt i asnjë kontrolli financiar apo moratoriumi të çfarëdo lloji, brenda territorit të palëve, SELEC-i është i lirë:

- a) të blejë nëpërmjet kanaleve të autorizuar çdo monedhë dhe t'i mbajë ose t'i shesë ato;
- b) të operojë llogari bankare në çdo monedhë.

KREU III

PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E PERSONAVE TË ANGAZHUAR ME PUNË NË SELEC

Neni 9

Privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve të shteteve anëtare

1. Përfaqësuesit e shteteve anëtare, gjatë kohës së ushtrimit të misionit të tyre në SELEC dhe gjatë udhëtimeve të tyre për dhe nga vendet e mbledhjeve të organizuara nga SELEC-i, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

- a) imunitetin ndaj arrestimit apo ndalimit të personit dhe sekuestrimit të bagazheve të tyre personale;
- b) imunitetin ndaj çdo lloji procesi ligjor në lidhje me fjalët e shprehura apo të shkruara dhe për të gjitha veprimet e kryera nga ta në cilësinë e tyre si përfaqësues; ky imunitet do të vazhdojë të akordohet pavarësisht se personat në fjalë mund të kenë pushuar ushtrimin e funksioneve të tyre si përfaqësues;
- c) paprekshmërinë e dokumentacionit zyrtar, informacioneve dhe materialeve të tjera zyrtare në zotërim të tyre;
- d) të drejtën për të përdorur kode dhe për të marrë dokumente e korrespondenca me korrier apo në çanta të vulosura;
- e) përfshirja e vetë atyre dhe i bashkëshortëve nga kufizimet e emigracionit dhe formaliteteve për regjistrimin e shtetasve të huaj në vendin e Palës që vizitojnë apo kalojnë tranzit për ushtrimin e funksioneve të tyre;
- f) të njëjtat lehtësira në lidhje me monedhat apo kufizimet në konvertimin e tyre, siç u akordohen përfaqësuesve të qeverive të huaja në misionet e tyre zyrtare të përkohshme;
- g) të njëjtat imunitete dhe lehtësira në lidhje me bagazhet e tyre personale, siç u akordohen agjentëve diplomatikë;

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të aplikohet ndërmjet një përfaqësuesi dhe shtetit anëtar nga i cili ai/ajo është shtetas apo rezident i përhershëm apo ai/ajo është ose ka qenë përfaqësues.

Neni 10

Privilegjet dhe imunitetet e koordinatorëve

1. Në vendet pritëse, koordinatorëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre që janë pjesë e këtyre familjeve, u akordohen privilegjet dhe imunitetet, përfshirjet dhe lehtësirat që u akordohen agjentëve diplomatikë dhe anëtarëve të familjeve të tyre në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961.

2. Koordinatorët nuk angazhohen në asnjë veprimtari fitimprurëse në vendet pritëse, përveç atyre që rezultojnë nga funksionet e tyre në SELEC.

3. Koordinatorët që janë shtetas apo rezidentë të përhershëm në vendin pritës gëzojnë imunitet ndaj çdo procesi ligjor dhe janë të paprekshëm vetëm në lidhje me veprimet zyrtare që kryhen gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

4. Në territorin e Palëve, veç vendit pritës, koordinatorët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të lidhur me punën në SELEC, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që aplikohen për përfaqësuesit e shteteve anëtare, siç përcaktohet në nenin 9, me përjashtim të pikave e dhe g të nenit 9, paragrafi 1.

Neni 11

Privilegjet dhe imunitetet e drejtorit të përgjithshëm, drejtorëve dhe stafit të SELEC-it

1. Drejtori i përgjithshëm, drejtorët dhe stafi i SELEC-it:

a) do të jenë të imunizuar nga çdo proces ligjor edhe pas përfundimit të punës së tyre në SELEC në lidhje me fjalët e shprehura ose të shkruara dhe për të gjitha veprimet e kryera nga ta në funksionet e tyre zyrtare dhe brenda kufijve të kompetencave të tyre;

b) do të përjashtohen nga taksimi i rrogave, shpërblimeve dhe pagesave që SELEC-i u bën atyre;

c) do të përjashtohen, bashkë me anëtarët e familjeve të tyre që përbëjnë këto familje, nga kufizimet e emigracionit dhe formalitetet për regjistrimin e shtetasve të huaj;

d) do të akordohen të njëjtat lehtësira në lidhje me monedhat dhe kufizimet në konvertimin e tyre siç u akordohen anëtarëve në nivele të krahasueshme me ato të misioneve diplomatike;

e) do t'u jepen, bashkë me anëtarët e familjeve të tyre që përbëjnë këto familje, të njëjtat lehtësira riatdhësimi në kohën e krizave ndërkombëtare, siç u akordohen anëtarëve të nivelit të krahasueshëm të misioneve diplomatike;

f) do të kenë të drejtë, në vendin pritës, në përputhje me ligjet dhe rregullat e tij, për të importuar pa taksë doganore mobiliet dhe sendet e tyre personale, duke përfshirë një automjet, në kohën kur fillojnë për herë të parë punën në postin e caktuar dhe kanë të drejtë t'i eksportojnë ato pa taksë doganore kur përfundojnë funksionin e tyre në SELEC;

g) nuk janë të detyruar të japin të dhëna si dëshmitarë në lidhje me detyrat e tyre zyrtare; dhe

h) do të gëzojnë paprekshmëri për të gjitha shkresat, dokumentacionin dhe materialet e tjera zyrtare në lidhje me SELEC-in.

2. Përveç privilegjeve dhe imuniteteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorëve të tjerë iu akordohen në vendin pritës, vetë atyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre që përbëjnë këto familje, privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet dhe lehtësirat që iu akordohen agjentëve diplomatikë dhe anëtarëve të familjeve të tyre në përputhje me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të datës 18 prill 1961.

3. Privilegjet dhe imunitetet e drejtorit të përgjithshëm, drejtorëve të tjerë dhe stafit të SELEC-it të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, pikat "b" deri te "f" dhe në paragrafin 2 të këtij neni, nuk do të aplikohen në lidhje me Palën nga e cila personi është shtetas apo rezident i përhershëm.

Neni 12

Privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve të partnerëve operacionalë

Përfaqësuesit e partnerëve operacionalë që vendosen në SELEC në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi u akordohen privilegje dhe imunitete, siç u akordohen koordinatorëve të shteteve anëtare në atë masë që këto privilegje dhe imunitete kufizohen në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet partnerëve operacionalë dhe SELEC-it.

Neni 13 Njoftimet

1. Secila Palë i njofton drejtorit të përgjithshëm dhe depozitarit emrat dhe pozicionet/funksionet e përfaqësuesve të saj dhe të koordinatorëve, si dhe anëtarët e familjes së koordinatorëve që janë anëtarë të familjes.

2. Secili partner operacional i njofton drejtorit të përgjithshëm dhe depozitarit emrat e përfaqësuesve të tij.

3. Drejtori i përgjithshëm përcakton në një listë të përditësuar që i komunikohet secilës Palë emrat dhe funksionet e personave të renditur më poshtë:

- a) Drejtori i përgjithshëm;
- b) Drejtorët;
- c) Anëtarët e stafit të SELEC-it;
- d) Koordinatorët; dhe
- e) Përfaqësuesit e partnerëve operacionalë.

Neni 14 Hyrja, qëndrimi, largimi dhe tranziti

Palët krijojnë lehtësira, kur është e nevojshme, për hyrjen dhe qëndrimin në territorin e një Pale dhe nuk krijojnë asnjë pengesë për largimin nga ajo Palë të personave të renditur më poshtë kur kjo hyrje apo ky qëndrim lidhet me aktivitetet zyrtare të SELEC-it dhe merr masa që atyre të mos u krijohet asnjë pengesë gjatë kalimit tranzit për ose nga vendi ku ata kanë një punë zyrtare të lidhur me SELEC-in:

- a) Përfaqësuesit e shteteve anëtare;
- b) Koordinatorët; dhe
- c) Drejtori i përgjithshëm, drejtorët dhe stafi i SELEC-it.

Neni 15 Kohëzgjatja e privilegjeve dhe imuniteteve

1. Në territorin e vendit pritës, çdo person që ka të drejtën e privilegjeve dhe imuniteteve në përputhje me këtë titull do t'i gëzojë këto privilegje dhe imunitete nga momenti kur ai/ajo hyn në vendin pritës për të kryer procedurat e marrjes së detyrës së saj/tij, ose, nëse ndodhet aktualisht në vendin pritës, nga momenti kur autoritetet kompetente të vendit pritës njoftohen për mbërritjen e tij/e saj nga Pala dërguese. Kur këta persona e përfundojnë detyrën e tyre, privilegjet dhe imunitete që ata gëzojnë në vendin pritës normalisht ndërpriten në momentin kur ata largohen nga vendi pritës, ose me skadimin e një afati të arsyeshëm për ta bërë këtë. Megjithatë, në lidhje me veprimet e kryera nga këta persona në ushtrimin e funksioneve të tyre, imuniteti do të vazhdojë të veprojë.

2. Gjatë ushtrimit të punës zyrtare të saj/tij në lidhje me SELEC-in në territorin e Palëve përveç vendit pritës, çdo person që ka të drejtën e privilegjeve dhe imuniteteve në përputhje me këtë të drejtë do të gëzojë këto privilegje dhe imunitete nga momenti kur ai/ajo hyn në territorin e Palës në fjalë dhe gjatë qëndrimit të tij/saj në territorin e kësaj Pale. Megjithatë, kuptohet se asgjë në këtë protokoll nuk do të pengojë autoritetet përkatëse të Palëve të kërkojnë të dhëna të arsyeshme nga SELEC-i ku të konfirmohet se personat që pretendojnë trajtimin e përcaktuar në këtë protokoll po udhëtojnë për punë zyrtare të SELEC-it.

Neni 16 Kufizimi i imuniteteve

Imuniteti ndaj proceseve ligjore nuk aplikohet në lidhje me një padi civile për dëmet e rezultuara nga një aksident në territorin e një Pale të shkakuar nga një automjet, anije ose avion që

përdoret nga çdo përfaqësues i një shteti anëtar, nga koordinatorët, drejtori i përgjithshëm, drejtorët, anëtarët e stafit të SELEC-it, ose përfaqësuesit e një partneri operacional, dhe as imuniteti nga një proces ligjor nuk aplikohet në lidhje me një shkelje të rregullave të trafikut.

Neni 17

Heqja e imuniteteve

1. Privilegjet dhe imunitetet në këtë protokoll akordohen jo për përfitime personale të vetë personave, por me qëllim që të sigurohet ushtrimi i pavarur i funksioneve të tyre në lidhje me SELEC-in.

2. Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, është detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegje dhe imunitete të tilla në përputhje me këtë protokoll, të respektojnë ligjet dhe rregullat e vendit pritës dhe të Palëve të tjera.

3. Kompetencat për heqjen e imunitetit janë si më poshtë:

a) në lidhje me përfaqësuesit dhe koordinatorët e shteteve anëtare heqja e imunitetit do të jetë në kompetencë të Palës dërguese. Kjo Palë do të ketë të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetin në rastet kur, sipas mendimit të saj, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe nuk do të cenonte qëllimet për të cilat është dhënë imuniteti;

b) në lidhje me drejtorin e përgjithshëm dhe drejtorët, Këshilli do të ketë të drejtën dhe detyrën të heqë imunitetin kur imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e SELEC-it;

c) në lidhje me ndonjë anëtar të stafit të SELEC-it, drejtori i përgjithshëm do të ketë të drejtën dhe detyrën për heqjen e imunitetit kur imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e SELEC-it;

d) në lidhje me përfaqësuesit e një partneri operacional, heqja e imunitetit do të jetë në kompetencë të partnerit operacional dërgues. Ky partner operacional ka të drejtën dhe detyrën të heqë imunitetin në rastet kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe nuk do të cenonte qëllimet për të cilat është dhënë imuniteti.

4. Asnjë heqje e tillë imuniteti nuk shtrihet te ndonjë masë ekzekutimi për të cilën është e nevojshme heqje imuniteti e veçantë.

5. SELEC-i do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet kompetente të Palëve dhe të partnerëve operacionalë, me qëllim që të lehtësojë administrimin e duhur të drejtësisë dhe të parandalojë çdo abuzim me privilegjet dhe imunitetet e dhëna në bazë të dispozitave të këtij protokoll.

KREU IV

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 18

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky Protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga shtetet nënshkruese në Konventën e SELEC-it.

2. Ky Protokoll është subjekt ratifikimi, pranimi apo miratimi nga shtetet nënshkruese, në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse.

3. Pas hyrjes së saj në fuqi, çdo Palë tjetër në Konventën e SELEC-it mund të aderojë në këtë protokoll.

4. Dokumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te depozitari.

Neni 19
Rezervat

Këtij Protokollit nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Neni 20
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e protokollit

1. Ky Protokoll do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës kur nëntë shtete nënshkruese të kenë depozituar dokumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit.
2. Për çdo shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë protokoll pas datës hyrjes së tij në fuqi, ky Protokoll do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit nga ai shtet të instrumenteve përkatëse.
3. Ky Protokoll do të mbetet në fuqi për aq kohë sa të jetë në fuqi Konventa e SELEC-it.

Neni 21
Ndryshimet

1. Ky Protokoll mund të ndryshohet me propozim të çdo Pale.
2. Çdo propozim i tillë u komunikohet palëve nga drejtori i përgjithshëm të paktën gjashtë muaj para dorëzimit të tij në Këshill për shqyrtim dhe miratim.
3. Ndryshimet e këtij Protokollit, të miratuara në përputhje me paragrafin 2 të mësipërm janë subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga Palët dhe hyjnë në fuqi sipas procedurave të përcaktuara në nenin 20.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve ose ndërmjet një pale dhe SELEC-it në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokollit, palët e interesuara do të përpiqen t'i zgjidhin nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve të ndërsjella. Nëse këto konsultime dhe bisedime nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda gjashtë muajve, palët do t'ia paraqesin çështjen Këshillit për shqyrtim dhe veprimet e nevojshme.

Neni 23
Tërheqja

1. Çdo Palë mund të tërhiqet nga ky Protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim dërguar sekretariatit të SELEC-it dhe depozitarit, i cili më pas i dërgon një kopje të vërtetuar të këtij njoftimi secilës Palë.
2. Çdo Palë që tërhiqet nga Konventa e SELEC-it në bazë të procedurave të përcaktuara në nenin 51 të kësaj Konvente, tërhiqet në të njëjtën kohë nga ky Protokoll.
3. Tërheqja bëhet e vlefshme tre muaj pas datës në të cilën depozitari merr njoftimin.

Neni 24
Depozitari

1. Qeveria e Rumanisë vepron si depozitari i këtij protokollit.
2. Depozitari i dërgon një kopje të vërtetuar me origjinalin sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Originali i këtij Protokoll, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, depozitohet te depozitari, i cili i dërgon secilës palë një kopje të vërtetuar.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

Bërë në _____ më _____

VENDIM
Nr.931, datë 17.11.2010

PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
AZERBAJXHANIT, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE E TË SHËRBIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike e të shërbimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT MBI HEQJEN E VIZAVE PËR
MBAJTËSIT E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Azerbajxhanit (më poshtë të quajtura “Palët kontraktuese”);

të nisura nga dëshira për lehtësimin e hyrjes, daljes dhe lëvizjes së qytetarëve të tyre ndërmjet dy vendeve, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qytetarët e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit mund të hyjnë, të qëndrojnë, të kalojnë tranzit dhe të largohen nga territori i palës tjetër kontraktuese pa vizë për një periudhë jo më të gjatë se 90 ditë brenda 180 ditëve nga data e hyrjes së parë.

Neni 2

Qytetarët e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, që janë pjestarë të stafit të misionit diplomatik ose postit konsullor apo të një organizate ndërkombëtare me seli në territorin e palës tjetër kontraktuese dhe pjesëtarët e familjes në ngarkim të tyre kanë të drejtë të hyjnë pa vizë në territorin e palës tjetër kontraktuese.

Neni 3

Qytetarët e secilit shtet ose palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike ose të shërbimit do të hyjnë, largohen dhe qëndrojnë tranzit në territorin e shtetit ose palës tjetër kontraktuese në çdo pikë të kalimit kufitar të caktuar për qarkullim ndërkombëtar.

Neni 4

1. Në rast të humbjes ose dëmtimit të pasaportave diplomatike ose të shërbimit, qytetari i secilit shtet ose palës kontraktuese në territorin e shtetit ose palës tjetër kontraktuese që është mbajtës i kësaj pasaporte do të njoftojë Ministrinë e Punëve të Jashtme të palës tjetër kontraktuese.

2. Në vend të pasaportave të humbura ose të dëmtuara diplomatike dhe të shërbimit, misioni ose posti konsullor i shtetit, qytetar i të cilit është mbajtësi i kësaj pasaporte, do të lëshojë një dokument të ri udhëtimi.

Neni 5

1. Qytetarët e secilës palë kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit do t'u përmbahen ligjeve dhe rregullave ekzistuese të palës tjetër kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin e atij shteti ose pale kontraktuese.

2. Kjo Marrëveshje nuk kufizon të drejtën e palës kontraktuese për t'i mohuar hyrjen ose për t'ia konsideruar të përfunduar periudhën e qëndrimit në territoret e tyre shtetërore qytetarëve të shtetit ose palës kontraktuese, të cilët ajo mund t'i konsiderojë si "persona të padëshiruar".

Neni 6

1. Palët kontraktuese kanë të drejtë të pezullojnë në mënyrë të përkohshme dhe tërësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, për shkaqe që lidhen me rendin dhe sigurinë kombëtare ose shëndetin publik.

2. Palët kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën menjëherë, por jo më vonë se 48 orë nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi vendimin për miratimin dhe përfundimin e këtij pezullimi.

Ky vendim do të hyjë në fuqi 24 orë pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

Neni 7

1. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë nëpërmjet kanaleve diplomatike modelet e pasaportave të vlefshme diplomatike dhe të shërbimit, jo më vonë se 30 ditë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kur njëra palë kontraktuese lëshon një pasaportë ose bën ndryshime në pasaportat e shkëmbyera, këto ndryshime do të njoftohen nëpërmjet kanaleve diplomatike, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të vlefshmërisë së pasaportave të reja ose ndryshimeve të bëra në to, duke bashkëngjitur një model të dokumentit të ri.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë interpretimit ose zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 9

Çdo ndryshim në këtë Marrëveshje do të bëhet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve kontraktuese, si pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të hyjë në fuqi sipas dispozitës së nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 10

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një afat të pacaktuar kohe dhe do të hyjë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas datës së marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi plotësimin e kërkesave të parashikuara në legjislacionin kombëtar të të dyja Palëve Kontaktuese.

2. Secila Palë Kontraktuese mund të përfundojë këtë Marrëveshje, në çdo kohë, duke njoftuar Palën tjetër me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike, ndërsa vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje do të ndërpritet 90 (nëntëdhjetë) ditë pas datës së marrjes së këtij njoftimi.

Bërë në më 2010, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, azerbajxhanase dhe angleze, duke pasur të tria tekstet fuqi të barabartë. Në rast mospajtimesh në interpretim, mbizotërues do të jetë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM **Nr.932, datë 17.11.2010**

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E GARANTIMIT TË RREGULLIT DHE TË SIGURISË NË GJYKATA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 41 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 “Për organizmin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 29 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e garantimit të rregullit dhe të sigurisë në gjykata”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE **PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E GARANTIMIT TË RREGULLIT DHE SIGURISË NË GJYKATA**

KREU I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave lidhur me rendin dhe sigurinë në gjykata, si një aspekt i mbrojtjes së pavarësisë së pushtetit gjyqësor, nëpërmjet të cilave synohet:

a) Mbrojtja e personave, duke përfshirë gjyqtarët, punonjësit e administratës së gjykatës, palët në proces, personat e thirrur nga gjykata në proces, si dhe publikun;

b) Mbrojtja e objekteve, duke përfshirë godinën e gjykatës, objektet që ndodhen në të, si dhe në territorin përreth saj.

Neni 2
Përkufizime

a) "Punonjës sigurie" kuptohen punonjësit e ngarkuar për të garantuar rendin dhe sigurinë në gjykata, të cilët janë pjesë e shërbimit të vijueshëm të policisë, sipas nenit 41 pika 1 të ligjit nr.9877/2008 dhe nenit 29 të ligjit nr.8588/2000.

b) "Gjykatë" kuptohen gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, si dhe Gjykata e Lartë.

c) "Ambiente të gjykatës" kuptohen ambientet e brendshme të gjykatës dhe trualli funksional përreth saj, duke përfshirë edhe parkingun për automjetet.

Neni 3
Drejtimi i personelit të sigurisë

Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë së personelit të sigurisë bëhet nga kryetari i gjykatës dhe kancelari.

KREU II
SIGURIA NË HYRJE

Neni 4
Hyrja në godinën e gjykatës

1. Hyrja e publikut në godinën e gjykatës realizohet vetëm nëpërmjet hyrjes kryesore pas verifikimit të dokumentit të identifikimit nga punonjësi i sigurisë.

2. Hyrja kryesore e godinës së gjykatës mbikëqyret nga një punonjës i sigurisë, i cili gjatë ushtrimit të detyrës mban uniformë të veçantë me qëllim evidentimin nga publiku.

3. Çdo person i nënshtrohet procedurave të kontrollit dhe sigurisë në momentin e hyrjes në godinën e gjykatës.

4. Gjyqtarët, punonjësit e administratës së gjykatës, si dhe personat e autorizuar nga kryetari i gjykatës hyjnë në godinën e gjykatës nëpërmjet një hyrje të veçantë.

5. Hyrja e veçantë e gjykatës e parashikuar në pikën 4, shërben edhe si dalje emergjence në rastet kur jepet urdhër për evakuim nga kryetari i gjykatës.

Neni 5
Hyrja e automjeteve

1. Hyrja e automjeteve në dispozicion të gjykatës, automjeteve private të gjyqtarëve dhe të punonjësve të administratës, si dhe e mjeteve, të cilat transportojnë të akuzuarit nga institucionet e paraburgimit dhe të dënuarit nga institucionet e vuajtjes së dënimit, për të marrë pjesë në seancë gjyqësore, realizohet përmes portave të veçanta për hyrjen e automjeteve.

2. Hapësira e parkimit rreth godinës së gjykatës përdoret vetëm për automjetet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 6
Siguria në godinën e gjykatës

1. Kryetari i gjykatës përcakton rregulla të hollësishme lidhur me vendosjen e pajisjeve të nevojshme të sigurisë në hyrjen kryesore dhe në brendësi të godinës së gjykatës, në varësi të shkallës së rrezikshmërisë të vlerësuar në vijimësi në bashkëpunim me personelin e sigurisë.

2. Rregullat bazë të sigurisë që duhet të përmbushë secila prej gjykatave janë:

a) pajisja me detektorë elektronikë, të cilat vendosen pranë hyrjes kryesore;

b) vendosja e pajisjeve për fikjen e zjarrit në ambientet e godinës së gjykatës;

c) pajisja me mjete të sigurisë (çelësa, karta apo mjete të tjera të kësaj natyre) e punonjësve të administratës së gjykatës, me qëllim realizimin e hyrjes nëpërmjet hyrjes së veçantë të godinës së gjykatës.

3. Informacioni i përmbledhur mbi rregullat bazë të sigurisë shpallet në një vend të dukshëm në ambientet hyrëse të gjykatës.

KREU III PERSONELI I SIGURISË

Neni 7

Hapësira e veprimtarisë së personelit të sigurisë

1. Personeli i sigurisë garanton rendin dhe sigurinë në:

- a) hyrjen kryesore të gjykatës;
- b) portën për hyrjen e automjeteve dhe hapësirën e parkimit;
- c) sallën e gjyqit, nëse i kërkohet nga kryetari i trupit gjykues;
- d) ambientet e tjera të brendshme të godinës së gjykatës, të cilat përfshijnë kryesisht korridoret lidhëse pranë zyrave të gjyqtarëve.

Neni 8

Detyrat e personelit të sigurisë

1. Punonjësit e sigurisë në gjykata kanë këto detyra:

- a) Sigurojnë ndalimin e hyrjes për personat, të cilët paraqesin rrezik për sigurinë në gjykatë;
- b) Ushtrojnë kontroll personal nëpërmjet pajisjeve teknike dhe inspektojnë çantat e personave që hyjnë në ambientet e brendshme të gjykatës;
- c) Marrin masa për bllokimin e sendeve, mbajtja dhe futa në gjykatë e të cilave është e ndaluar sipas kësaj rregulloreje;
- ç) Informojnë kryetarin e gjykatës apo kancelarin për sjellje të dyshimta nga personat që gjenden në godinën e gjykatës;
- d) Marrin masa për kufizimin e qarkullimit të automjeteve të palejuara në hapësirat e parkimit, në garazhe, si dhe në oborrin e gjykatës;
- dh) Përdorin forcën fizike në përputhje dhe proporcion me rastet që e kanë diktuar atë dhe aq sa është e nevojshme për të shmangur apo neutralizuar situatën e rrezikut të krijuar;
- e) Raportojnë pranë kryetarit të gjykatës ose kancelarit telefonatat që përmbajnë kërcënime të shprehura apo nënkuptojnë mundësinë e një rreziku për gjyqtarët apo punonjësit e administratës së gjykatës;
- ë) Japin udhëzime të shprehura në zbatim të urdhrave të kryetarit ose kancelarit të gjykatës;
- f) Mbajnë kontakte të vazhdueshme me institucione, si: policia, spitalet, zjarrfikëset dhe ia raportojnë periodikisht kryetarit ose kancelarit të gjykatës;
- g) Ndërmarrin kontrole rutinë për pajisjet e sigurisë dhe i raportojnë kryetarit ose kancelarit të gjykatës në rast mosfunksionimi të këtyre pajisjeve;
- gj) Kryejnë evakuimin e godinës në zbatim të urdhrat verbal të kryetarit të gjykatës. Në rastet e rrezikut të madh e të menjëhershëm, evakuimi mund të kryhet edhe pa urdher të kryetarit të gjykatës.
- h) Informojnë menjëherë kryetarin, kancelarin, si dhe policinë e shtetit për çdo ngjarje të rëndë që cenon sigurinë e gjykatës, e cila konstatohet pas orarit zyrtar.

2. Sendet, hyrja apo futja e të cilave është e ndaluar në godinën e gjykatës janë, por nuk kufizohen vetëm në to, të mëposhtmet:

- a) armë zjarri;

- b) eksplozivë;
 - c) thika të çfarëdo gjatësie;
 - ç) sende të mprehta ose me majë (duke përfshirë: brisqe, gershërë, kaçavida ose çdo send tjetër të ngjashëm);
 - d) spray për mbrojtje;
 - dh) pranga;
 - e) kafshë;
 - ë) lëndë dhe substanca narkotike;
 - f) çdo mjet tjetër që mund të përbëjë rrezik për sigurinë dhe rendin në gjykatë.
3. Në rastin kur mbajtja e sendeve të ndaluara përbën veprë penale punonjësit e sigurisë autorizohen të kryejnë arrestimin në flagrancë të mbajtësit të saj dhe ta dorëzojnë menjëherë në policinë gjyqësore, së bashku me sendin e ndaluar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Rregullat e sendeve të ndaluara nuk zbatohet në rastet lidhur me:
- a) persona, të cilët me ligj iu lejohej mbajtja e armëve të zjarrit; ose
 - b) sendet përbëjnë provë materiale dhe paraqiten si të tilla në gjykatë.

KREU IV DREJTIMI I PERSONELIT TË SIGURISË

Neni 9

Kompetencat e kryetarit të gjykatës

1. Kryetari i gjykatës drejton dhe kontrollon veprimtarinë e personelit të sigurisë në gjykata.
2. Kryetari i gjykatës ushtron këto kompetenca:
 - a) Jep urdhra verbalë për evakuim si më poshtë:
 - në rast rreziku brenda godinës, që nuk mund të evitohet në mënyrë tjetër;
 - në rast aktivizimi të sistemit të alarmit për rënien e zjarrit.
 - b) Merr kontakte të herëpashershme me strukturat drejtuese të Policisë së Shtetit për të siguruar rendin në gjykatë;
 - c) Harton, në bashkëpunim me kancelarin, planet e veprimit për sigurimin e rendit në gjykatë, si dhe masat e sigurisë;
 - ç) Merr çdo masë tjetër të nevojshme për të garantuar rendin dhe sigurinë në gjykatë.

Neni 10

Kompetencat e kancelarit

1. Kancelari i gjykatës asiston kryetarin e gjykatës për zbatimin e rregullave të sigurisë dhe ushtron këto kompetenca:
 - a) Kujdeset për zbatimin e detyrave nga personeli i sigurisë dhe nga administrata gjyqësore;
 - b) Kujdeset për mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e infrastrukturës së nevojshme për garantimin e rendit dhe sigurisë;
 - c) Administron ankesat e qytetarëve ndaj punonjësve të sigurisë dhe administratës gjyqësore mbi rregullat e sigurisë;
 - ç) Merr masat për shpalljen me afishim të informacionit mbi rregullat bazë të sigurisë në gjykatë;
 - d) Kryen çdo detyrë tjetër të deleguar nga kryetari i gjykatës për zbatimin e rregullave të sigurisë.

Neni 11
Zbatimi i rregullores

1. Kjo rregullore është e detyrueshme për zbatim nga të gjithë punonjësit e personelit të sigurisë së gjykatave. Shkelja e dispozitave të kësaj rregulloreje passjell përgjegjësi administrative, disiplinore.

2. Kryetarët dhe kancelarët e gjykatave marrin masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 12
Dispozitë tranzitore

Deri në momentin e krijimit të hyrjes së veçantë në godinën e gjykatës, sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, në gjykatat që nuk kanë një të tillë, gjyqtarët dhe personeli i administratës gjyqësore hyjnë nëpërmjet hyrjes ekzistuese në godinën e gjykatës, duke treguar dokumentin e identifikimit të punës pa iu nënshtruar kontrollit nga punonjësi i sigurisë.

VENDIM
Nr.934, datë 17.11.2010

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR
USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të Konventës së Këshillit të Europës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”, Strasburg, 25.1.1996, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KONVENTA EUROPIANE
MBI USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE
STRASBURG, 25.1.1996

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese,

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është të arrijë unitet më të madh ndërmjet anëtarëve të tij;

duke pasur parasysh Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve dhe në veçanti nenin 4, i cili i kërkon shteteve palë të marrin të gjitha masat e duhura legislative, administrative dhe të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura në këtë Konventë;

duke vërejtur përmbajtjen e rekomandimit 1121 (1990) të Asamblesë Parlamentare mbi të drejtat e fëmijëve;

të bindur se të drejtat dhe interesat më të mira të fëmijëve duhet të promovohen dhe për këtë qëllim fëmijët duhet të kenë mundësinë të ushtrojnë të drejtat e tyre, në veçanti në procedurat familjare që ndikojnë tek ta;

duke konfirmuar se fëmijëve duhet t'u sigurohet informacion përkatës për të mundësuar promovimin e këtyre të drejtave dhe interesave më të mira dhe që pikëpamjeve të fëmijëve duhet t'u jepet rëndësia e duhur;

duke njohur rëndësinë e rolit të prindërve në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave më të mira të fëmijëve dhe duke pasur parasysh se, kur është e nevojshme, shtetet duhet të angazhohen në një mbrojtje dhe promovim të tillë;

duke pasur parasysh, megjithatë, se në rast të konfliktit është e dëshirueshme për familjet që të përpiqen të arrijnë një marrëveshje para se ta paraqesin çështjen para një autoriteti gjyqësor, kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I

FUSHA E VEPRIMIT, OBJEKTI I KONVENTËS DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Fusha e veprimit dhe objekti i Konventës

1. Kjo Konventë zbatohet për fëmijët që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç.
2. Objekti i kësaj Konvente është, në interesat më të mira të fëmijëve, që të promovojë të drejtat e tyre, t'u japë atyre të drejta procedurale dhe të lehtësojë ushtrimin e këtyre të drejtave, duke siguruar që fëmijët, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, të informohen dhe të lejohen për të marrë pjesë në procedime që ndikojnë tek ta para një autoriteti gjyqësor.
3. Për qëllime të kësaj Konvente, procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë fëmijët janë procedimet familjare, në veçanti ato që përfshijnë ushtrimin e përgjegjësive prindërore, si vendbanimi dhe aksesit te fëmijët.
4. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, përcakton të paktën tri kategori të çështjeve familjare para një autoriteti gjyqësor për të cilat duhet të zbatohet kjo Konventë.
5. Çdo Palë, me anë të një deklarate të mëtejshme, mund të përcaktojë kategori shtesë të çështjeve familjare për të cilën duhet të zbatohet kjo Konventë ose të japë informacion në lidhje me zbatimin e nenit 5 paragrafi 2 të nenit 9 paragrafin 2 të nenit 10 dhe nenin 11.
6. Asgjë në këtë Konventë nuk pengon Palët që të zbatojnë rregulla më të favorshme për promovimin dhe ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- a) termi "autoritet gjyqësor" nënkupton një gjykatë ose autoritet administrativ që ka kompetenca të barasvlefshme;
- b) termi "mbajtësit e përgjegjësive prindërore" nënkupton prindërit dhe persona të tjerë ose organe, të cilat kanë të drejtë të ushtrojnë disa ose të gjitha përgjegjësitë prindërore;
- c) termi "përfaqësues" nënkupton një person, si për shembull, një avokat apo organ i caktuar për të vepruar para një autoriteti gjyqësor në emër të një fëmije;
- d) termi "informacion përkatës" nënkupton një informacion që është i përshtatshëm për moshën dhe arsyetimin e fëmijës, dhe që do të jepet për t' i mundësuar fëmijës të ushtrojë plotësisht të drejtat e tij apo të saj, përveçse kur dhënia e këtij informacioni është në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës.

KREU II
MASAT PROCEDURALE PËR TË PROMOVUAR USHTRIMIN E TË DREJTAVE TË
FËMIJËVE

A. Të drejtat procedurale të fëmijëve

Neni 3

**E drejta për t'u informuar dhe për të
shprehur pikëpamjet e tij ose të saj në procedim**

Një fëmijë që, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet se ka arsytim të mjaftueshëm, në rast të procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ai/ajo, i jepet dhe ka të drejtë të kërkojë të drejtat e mëposhtme:

- a) të marrë të gjithë informacionin përkatës;
- b) të konsultohet dhe të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj;
- c) të informohet për pasojat e mundshme të përputhshmërisë me këto pikëpamje dhe pasojat e mundshme të çdo vendimi.

Neni 4

E drejta për të aplikuar për emërimin e një përfaqësuesi të veçantë

1. Në bazë të nenit 9, fëmija ka të drejtë të kërkojë, personalisht ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, një përfaqësues të posaçëm në procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë te fëmija ku ligji i brendshëm përjashton mbajtësit e përgjegjësive prindërore nga përfaqësimi i fëmijës, si rezultat i konfliktit të interesit me këtë të fundit.

2. Shtetet janë të lira të kufizojnë të drejtën në paragrafin 1, të fëmijëve, të cilët sipas ligjit të brendshëm konsiderohen se kanë arsytim të mjaftueshëm.

Neni 5

Të drejta të tjera të mundshme procedurale

Palët shqyrtojnë mundësinë e dhënies së të drejtave procedurale shtesë, fëmijëve në lidhje me procedimet para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ta, në veçanti:

- a) të drejtën që të kërkojnë ndihmë nga një person i përshtatshëm i zgjedhur prej tyre, me qëllim që t'i ndihmojë ata për të shprehur pikëpamjet e tyre;
- b) të drejtën që të kërkojnë vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, emërimin e një përfaqësuesi të veçantë, në raste të caktuara, një avokat;
- c) të drejtën për të emëruar përfaqësuesit e tyre;
- d) të drejtën për të ushtruar disa ose të gjitha të drejtat e palëve në këtë procedim.

B. Roli i autoriteteve gjyqësore

Neni 6

Procesi i vendimmarrjes

Në procedimet që ndikojnë te fëmija, para se të marrë një vendim, autoriteti gjyqësor:

a) shqyrton nëse ka informacione të mjaftueshme në dispozicion, me qëllim që të marrë një vendim në interesat më të mira të fëmijës dhe, kur është e nevojshme, të marrë informacione të mëtejshme, në veçanti nga mbajtësit e përgjegjësive prindërore;

b) në rastin kur fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet të ketë arsytim të mjaftueshëm:

- garanton që fëmija ka marrë të gjithë informacionin përkatës;

- këshillohet me fëmijën drejtpërdrejt në raste të caktuara, nëse është e nevojshme privatisht, vetë ose nëpërmjet personave ose organeve të tjera, në një mënyrë që përshtatet me arsyetimin e tij ose të saj, nëse kjo do të ishte haptazi në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës;

- lejon fëmijën të shprehë pikëpamjet e tij ose të saj;
- c) i jep rëndësinë e duhur pikëpamjeve të shprehura nga fëmija.

Neni 7

Detyrimi për të vepruar shpejt

Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor vepron shpejt për të shmangur çdo vonesë të panevojshme dhe vihen në dispozicion procedura për të garantuar që vendimet e tij të zbatohen me shpejtësi. Në raste urgjente, sipas rastit, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të marrë vendime, të cilat janë menjëherë të zbatueshme.

Neni 8

Detyrimi për të vetëvepruar

Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të vepruar sipas kërkesës së vet, në rastet e përcaktuara nga ligji i brendshëm, kur mirëqenia e një fëmije është në rrezik serioz.

Neni 9

Emërimi i një përfaqësuesi

1. Në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, ku sipas ligjit të brendshëm mbajtësit e përgjegjësive prindërore përjashtohen nga përfaqësimi i fëmijës si rezultat i një konflikti interesi ndërmjet tyre dhe fëmijës, autoriteti gjyqësor ka kompetencën për të caktuar një përfaqësues të posaçëm për fëmijën në këto procedime.

2. Palët veprojnë me kusht që, në procedimet që ndikojnë te një fëmijë, autoriteti gjyqësor do të ketë kompetencën për të caktuar një përfaqësues të veçantë, në raste të caktuara, një avokat për të përfaqësuar fëmijën.

C. Roli i përfaqësuesve

Neni 10

1. Në rastin e procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikon te një fëmijë, përveç nëse kjo do të ishte haptazi në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës, përfaqësuesi:

a) siguron të gjithë informacionin përkatës për fëmijën, nëse fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm;

b) jep shpjegime për fëmijën nëse fëmija, sipas ligjit të brendshëm, konsiderohet se ka arsyetim të mjaftueshëm në lidhje me pasojat e mundshme të përputhshmërisë me pikëpamjet e tij ose të saj dhe pasojat e mundshme të ndonjë veprimi nga ana e përfaqësuesit;

c) përcakton pikëpamjet e fëmijës dhe ia paraqet këto pikëpamje autoritetit gjyqësor.

2. Palët shqyrtojnë shtrirjen e dispozitave të paragrafit 1 për mbajtësit e përgjegjësive prindërore.

D. Zgjerimi i dispozitave të caktuara

Neni 11

Palët shqyrtojnë shtrirjen e dispozitave të neneve 3, 4 dhe 9 në procedimet që ndikojnë te fëmijët para organeve të tjera dhe për çështjet që ndikojnë te fëmijët, të cilët nuk janë objekt i procedimeve.

E. Organet kombëtare

Neni 12

1. Palët nxitin, nëpërmjet organeve që përmbushin, ndër të tjera, funksionet e përcaktuara në paragrafin 2, promovimin dhe ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

2. Funksionet janë si më poshtë:

a) të bëjnë propozime për të forcuar ligjin në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;
b) të japin mendime në lidhje me projektlegjislacionin mbi ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;

c) të sigurojnë informacione të përgjithshme në lidhje me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve në media, publik dhe personave e organeve që merren me çështje që lidhen me fëmijët;

d) të kërkojnë pikëpamjet e fëmijëve dhe t'i pajisin ata me informacione përkatëse.

F. Çështje të tjera

Neni 13

Ndërmjetësimi ose proceset e tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Me qëllim parandalimin ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo shmangien e procedimeve para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë te fëmijët, Palët inkurajojnë ofrimin e ndërmjetësimit ose proceseve të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përdorimin e këtyre proceseve për të arritur marrëveshje në rastet e caktuara që duhet të përcaktohen nga Palët.

Neni 14

Ndihma dhe këshillimi ligjor

Kur ligji i brendshëm parashikon ndihmë apo këshillim ligjor për përfaqësimin e fëmijëve në procedime para një autoriteti gjyqësor që ndikojnë tek ta, këto dispozita zbatohen në lidhje me çështjet e mbuluara nga nenet 4 dhe 9.

Neni 15

Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

Kjo Konventë nuk kufizon aplikimin e çdo instrumenti tjetër ndërkombëtar që merret me çështjet e veçanta, të cilat dalin në kontekstin e mbrojtjes së fëmijëve dhe familjeve, dhe në të cilin një Palë e kësaj Konvente është ose bëhet Palë.

KREU III

KOMITETI I PËRHERSHËM

Neni 16

Themelimi dhe funksionet e Komitetit të Përhershëm

1. Komiteti i Përhershëm është ngritur për qëllimet e kësaj Konvente.

2. Komiteti i Përhershëm mban nën shqyrtim problemet në lidhje me këtë Konventë. Ai në veçanti:

a) mund të shqyrtojë ndonjë çështje të rëndësishme që lidhet me interpretimin ose zbatimin e Konventës. Konkluzionet e Komitetit të Përhershëm në lidhje me zbatimin e Konventës mund të marrin formën e një rekomandimi; rekomandimet miratohen me një shumicë prej tre të katërtat e votave;

b) mund të propozojë amendamente të Konventës dhe të shqyrtojë ato të propozuara në përputhje me nenin 20;

c) mund të ofrojë këshillim dhe ndihmë ndaj organeve kombëtare që funksionojnë në bazë të paragrafit 2 të nenit 12 dhe nxitin bashkëpunimin ndërkombëtar midis tyre.

Neni 17 **Përbërja**

1. Çdo Palë mund të përfaqësohet në Komitetin e Përhershëm nga një ose më shumë delegatë. Çdo Palë ka një votë.

2. Çdo shtet i përmendur në nenin 21, i cili nuk është palë në këtë Konventë, mund të përfaqësohet në Komisionin e Përhershëm nga një vëzhgues. E njëjta gjë vlen edhe për ndonjë shtet tjetër ose të Komunitetit Europian pasi të jetë ftuar për të aderuar në Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 22.

3. Nëse një Palë nuk ka informuar Sekretarin e Përgjithshëm për kundërshtimin e saj, të paktën një muaj para mbledhjes, Komiteti i Përhershëm mund të ftojë sa më poshtë për të marrë pjesë si vëzhgues në të gjitha takimet e tij ose në një takim apo pjesë të një takimi:

- cilindo shtet që nuk është përmendur në paragrafin 2 më lart;
- Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës;
- Komunitetin Europian;
- ndonjë organ ndërkombëtar qeveritar;
- ndonjë organ ndërkombëtar joqeveritar me një ose më shumë funksione të përmendura në paragrafin 2 të nenit 12;
- ndonjë organ kombëtar qeveritar ose joqeveritar me një ose më shumë funksione të përmendura në paragrafin 2 të nenit 12;
- Komiteti i Përhershëm mund të shkëmbejë informacion me organizatat përkatëse që merren me ushtrimin e të drejtave të fëmijëve.

Neni 18 **Takimet**

1. Në fund të vitit të tretë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe me nismën e vet, në çdo kohë pas kësaj date, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të ftojë Komisionin e Përhershëm për t'u takuar.

2. Vendimet mund të merren vetëm në Komisionin e Përhershëm nëse të paktën gjysma e Palëve janë të pranishme.

3. Sipas neneve 16 dhe 20, vendimet e Komitetit të Përhershëm do të merren nga shumica e anëtarëve të pranishëm.

4. Në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, Komiteti i Përhershëm harton rregullat e veta të procedurës dhe rregullat e procedurës të ndonjë pale pune që mund të jetë ngritur për të kryer të gjitha detyrat e caktuara sipas Konventës.

Neni 19 **Raportet e Komisionit të Përhershëm**

Pas çdo takimi, Komiteti i Përhershëm i përcjell Palëve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës një raport mbi diskutimet e tij dhe çdo vendim të marrë.

KREU IV **AMENDAMENTET E KONVENTËS**

Neni 20

1. Çdo ndryshim në nenet e kësaj Konvente, i propozuar nga një Palë ose nga Komiteti i Përhershëm i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe përcillet nga ai apo ajo, të paktën dy muaj para takimit të ardhshëm të Komitetit të Përhershëm, për shtetet anëtare të

Këshillit të Europës, çdo nënshkrues, çdo Palë, çdo shtet të ftuar për të nënshkruar këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 21 dhe çdo shtet apo Komuniteti European ftohen për të aderuar në të në përputhje me dispozitat e nenit 22.

2. Çdo ndryshim i propozuar në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm shqyrtohet nga Komiteti i Përhershëm, i cili dorëzon tekstin e miratuar me një shumicë prej tre të katërtat e votave të hedhura të Komitetit të Ministrave për miratim. Pas miratimit të tij, ky tekst i përcillet Palëve për pranim.

3. Çdo ndryshim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të periudhës prej një muaji pas datës në të cilën të gjitha Palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm se ata e kanë pranuar atë.

KREU V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 21

Nënshkrimi, ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet joanëtare, të cilat kanë marrë pjesë në përpunimin e saj.

2. Kjo Konventë i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose të miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës në të cilën tri shtete, duke përfshirë të paktën dy shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur me Konventën në përputhje me dispozitat e paragrafit të mësipërm.

4. Në lidhje me çdo nënshkrues që shpreh më pas pëlqimin e tij për t'u lidhur me të, Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Neni 22

Shtetet joanëtare dhe Komuniteti European

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, me nismën e vet ose me propozim të Komitetit të Përhershëm dhe pas konsultimit të Palëve, fton çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e Konventës, si dhe Komitetin European për të aderuar në këtë Konventë me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20, nënparagrafi d të Statutit të Këshillit të Europës, dhe me votim unanim të përfaqësuesve të shteteve kontraktuese të autorizuara për të marrë pjesë në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues ose Komunitetin European, Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 23

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, mund të përcaktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo Palë, në çdo datë të mëvonshme, me një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund ta shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të përcaktuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilit ajo është e autorizuar për të vepruar. Për sa i përket këtij territori, Konventa hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë në bazë të dy paragrafëve të mësipërm, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, mund të tërhiqet nga një njoftim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm. Tërheqja hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së deklaratës nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 24
Rezervat

Në Konventë nuk mund të bëhet asnjë rezervë.

Neni 25
Denoncimet

1. Çdo Palë mund të denoncojë në çdo kohë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi ditën e parë të muajit pas mbarimit të një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 26
Njoftimet

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit, çdo nënshkrues, çdo Palë dhe çdo shtet tjetër ose Komunitetin European që është ftuar të aderojë në këtë Konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitim e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 21 ose 22;
- d) çdo ndryshim të miratuar në përputhje me nenin 20 dhe datën në të cilën ky amendament hyn në fuqi;
- e) çdo deklaratë të bërë sipas dispozitave të neneve 1 dhe 23;
- f) çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të nenit 25;
- g) çdo akt tjetër, njoftim ose komunikim në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg më 25 janar 1996, në gjuhën angleze dhe frënge, ku të dyja tekstet janë njëllor të barasvlershme, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare, të cilat kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, Komunitetit European dhe çdo shteti të ftuar për të aderuar në këtë Konventë.

VENDIM
Nr.935, datë 17.11.2010

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR
STATUSIN JURIDIK TË FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË MARTESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtutës dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të Konventës së Këshillit të Europës “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martese”, sipas tekstit të bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

KONVENTA EVROPIANE MBI STATUSIN LIGJOR TË FËMIJËVE TË LINDUR JASHTË MARTESE

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të saj,

duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti sa më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, në veçanti me miratimin e rregullave të përbashkëta në fushën e ligjit;

duke vënë re se në një numër të madh të shteteve anëtare janë bërë ose po bëhen përpjekje për të përmirësuar statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese, duke zvogëluar dallimet ndërmjet statusit të tyre ligjor dhe atij të fëmijëve të lindur në martesë, të cilat janë në disavantazh juridik ose social të të parëve;

duke njohur se ende ekzistojnë mospërputhje të mëdha në ligjet e shteteve anëtare në këtë fushë;

duke besuar se situata e fëmijëve të lindur jashtë martese duhet të përmirësohet dhe se hartimi i disa rregullave të përbashkëta në lidhje me statusin e tyre ligjor do të ndihmojë këtë objektiv dhe në të njëjtën kohë do të kontribuojë për një harmonizim të ligjeve të shteteve anëtare në këtë fushë;

megjithatë, *duke pasur parasysh* se është e nevojshme të pranohen etapa progresive për ato shtete, të cilat nuk e konsiderojnë veten në gjendje të miratojnë menjëherë disa rregulla të kësaj Konvente,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Çdo palë kontraktuese merr përsipër të sigurojë përputhshmërinë e ligjit të saj me dispozitat e kësaj Konvente dhe të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Europës për masat e marra për këtë qëllim.

Neni 2

Njohja e mëmësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese do të bazohet vetëm në faktin e lindjes së fëmijës.

Neni 3

Njohja e atësisë së çdo fëmije të lindur jashtë martese mund të provohet ose përcaktohet nga njohja vullnetare ose me vendim gjykate.

Neni 4

Njohja vullnetare e atësisë nuk mund të kundërshtohet ose të kontestohet për aq sa parashikon ligji i brendshëm për këto procedura, përveç kur personi që kërkon të njohë ose që ka njohur fëmijën nuk është babai biologjik.

Neni 5

Veprimet që lidhen me provat shkencore të përkatësisë së atësisë, që mund të ndihmojnë për të vendosur ose kundërshtuar atësinë, janë të pranueshme.

Neni 6

1. Babai dhe nëna e një fëmije të lindur jashtë martese kanë të njëjtin detyrim për t'u kujdesur për fëmijën sikur të ishte lindur në martesë.

2. Kur detyrimi ligjor për t'u kujdesur për një fëmijë të lindur në martesë bie mbi anëtarë të caktuar të familjes së babait ose nënës, ky detyrim zbatohet, gjithashtu, në interes të fëmijës së lindur jashtë martese.

Neni 7

1. Kur njohja e një fëmije të lindur jashtë martese është përcaktuar për të dy prindërit, autoriteti prindëror nuk mund t'i atribuohet automatikisht vetëm babait.

2. Ekziston mundësia për të transferuar autoritetin prindëror, rastet e transferimit rregullohen me ligj të brendshëm.

Neni 8

Kur babai apo nëna e një fëmije të lindur jashtë martese nuk ka përgjegjësinë prindërore ose kujdestarinë e fëmijës, ky prind mund të përfitojë të drejtën e aksesit të fëmija në rastet e duhura.

Neni 9

Një fëmijë i lindur jashtë martese ka të njëjtën të drejtë të trashëgimisë në pasurinë e babait dhe nënës së tij, dhe të një anëtari të familjes së babait ose nënës të tij, sikur të kishte qenë i lindur në martesë.

Neni 10

Martesa ndërmjet babait dhe nënës së një fëmije të lindur jashtë martese i jep fëmijës statusin ligjor të fëmijës të lindur në martesë.

Neni 11

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose të miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

3. Në lidhje me një shtet nënshkrues që e ratifikon, e pranon ose e aprovon më pas, Konventa hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit apo miratimit.

Neni 12

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të aderojë në këtë Konventë.

2. Ky aderim bëhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të instrumentit të aderimit, i cili hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 13

1. Çdo shtet, në kohën e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, specifikon territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo shtet, gjatë depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose në çdo datë të mëvonshme, me deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, mund të shtrijë këtë Konventë në çdo territor ose territore të tjera të specifikuara në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilave është e autorizuar për të vepruar.

3. Çdo deklaratë e bërë në zbatim të paragrafit të mësipërm, në lidhje me çdo territor të përmendur në këtë deklaratë, mund të tërhiqet në pajtim me procedurat e përcaktuara në nenin 15 të kësaj Konvente.

Neni 14

1. Çdo shtet, në çastin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, ose kur bën një deklaratë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 13 të kësaj Konvente, nuk mund të bëjë më shumë se tri rezerva në lidhje me parashikimet e neneve 2 deri 10 të Konventës.

Rezerva të natyrës së përgjithshme nuk do të lejohen; çdo rezervë nuk mund të veprojë në më shumë se një dispozitë.

2. Një rezervë do të jetë e vlefshme për pesë vjet nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente për Palën Kontraktuese në fjalë. Ajo mund të rinovohet për periudha pasuese për pesë vjet me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës përpara skadimit të çdo periudhe.

3. Çdo palë kontraktuese mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë që ka bërë në pajtim me paragrafët e mësipërm me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, e cila hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj.

Neni 15

1. Çdo palë kontraktuese, për aq sa është e interesuar, mund të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Ky denoncim hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes të këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet, i cili ka aderuar në këtë Konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) çdo depozitim të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 11 të saj;
- d) çdo njoftim të marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 1;
- e) çdo deklaratë të marrë në zbatim të parashikimeve të paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 13;
- f) çdo rezervë të bërë në zbatim të parashikimeve të paragrafit 1 të nenit 14;
- g) rivendosja e çdo rezerve të kryer në zbatim të parashikimeve të paragrafit 2 të nenit 14;

h) tërheqja e çdo rezerve të kryer në zbatim të parashikimeve të paragrafit 3 të nenit 14;
i) çdo njoftim të marrë në zbatim të parashikimeve të nenit 15 dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar rregullisht për këtë, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Strasburg, më 15 tetor 1975, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet kanë të njëjtën fuqi, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve nënshkruese dhe aderuese.

VENDIM
Nr.936, datë 17.11.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.826, DATË 13.10.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË
PARË, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN
AKADEMIK 2010 - 2011”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14. 12. 1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, date 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Në vendimin nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
- “1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve të reja në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, për vitin 2010-2011, të jenë 9940. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:
- | | |
|---|--------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme | 9400; |
| b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë | 40; |
| c) Kuotat për transferim studimesh | 200; |
| ç) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj | 100; |
| d) Kuota për të verbrit | 20; |
| dh) Kuota për romët/ ballkano-egjiptianët | 20; |
| e) Kuota për të përndjekurit politikë | 160.”. |
2. Tabela nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, zëvendësohet me tabelën nr.1/1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Tabela nr.2, që i bashkëlidhet vendimit, zëvendësohet me tabelën nr.2/1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Tabela nr.3, që i bashkëlidhet vendimit, zëvendësohet me tabelën nr.3/1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1/1

KUOTA E PRANIMEVE TË REJA NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIM NË DISTANCË NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UD	UST	Shuma
1.	Histori	250					120			370
2.	Gjeografi	250					120			370
3.	Histori-Gjeografi			100	100					200
4.	Gjuhë-Letërsi	250		100	100	110	120			680
6.	Edukatë Qytetare			80						80
7.	Cikli i ulët			120	50	50	110	160		490
8.	Cikli i ulët (Filiali Peshkopi)						200	60		260
9.	Cikli i ulët parashkollor			130	100	75	120			425
10.	Edukim Fizik dhe Sporte								60	60
11.	Matematikë						60			60
12.	Teknologji Informacioni			50						50
13.	Fizikë						60			60
14.	Matematikë-Fizikë			70	100					170
15.	Biologji-Kimi			70	100		70			240
16.	Biologji	200								200
17.	Punë Sociale	100		100						200
18.	Filozofi-Sociologji			80						80
19.	Psikologji Sociologji							160		160
20.	Ekonomia dhe e Drejta			80						80
21.	Psikologji	100								100
22.	Drejtësi	400					130	100		630
23.	Drejtësi (filiali Peshkopi)							60		60
24.	Infermieri e Përgjithshme	260		105		280		100		790
25.	Infermieri e Përgjithshme (fil. Peshkopi)							60		60
26.	Mami	60								60
27.	Teknik Imazherie	90								90
28.	Teknik Laboratori	100								100
29.	Fizioterapi	80								80
30.	Administrim Publik				100					100
31.	Administrim-Biznes	200		105			100	200		605
32.	Financë-Kontabilitet	200		105	100	100	100	200		805
33.	Financë-Kontabilitet (filiali Peshkopi)							60		60
34.	Menaxhim					90				90
35.	Turizëm				100	75	100			275
36.	Marketing					75				75
37.	Turizëm (Pogradec)					60				60
39.	Menaxhim Agrobiznesi		100			75				175
40.	Ekonomi dhe P. Agrare		100							100
41.	Financë-Kontabilitet		100							100
42.	Mbrojtje bimësh		50							50
43.	Hortikulturë		50			75				125

44.	Prodhim bimor		50							50
45.	Zootečni dhe Biznes Blegtoral		50							50
46.	Akuakulturë dhe Menaxh. Peshkimi		50							50
47.	Agromjedis dhe Ekologji		80							80
48.	Tek. Agrorishqimore		50			75				125
49.	Vreshtari-Enologji		50							50
50.	Inxhinier Pyjesh		60							60
51.	Inxhinier Përpunim Druri		60							60
52.	Agromekanizim		50							50
	GJITHSEJ	2540	900	1340	850	1140	1410	1160	60	9400

PROGRAMI I STUDIMIT	UPT
Inxh.Mek/Inxh.Logjistik Prodhimi	40

TABELA NR. 2/1
TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAM TË PARË STUDIMI ME KOHË TË PJESSHME
PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011

Nr.	Universitetit	Tarifë për kredit për program të parë	Tarifë totale për program të parë
Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit			
1.	Hortikulturë	700	126,000
2.	Mbrojtje Bimësh	700	126,000
3.	Prodhim Bimor	700	126,000
4.	Zootekni dhe Biznes Blegtoral	700	126,000
5.	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	700	126,000
6.	Agromjedis dhe Ekologji	700	126,000
7.	Agromekanizim	700	126,000
Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit			
8.	Menaxhim Agrobiznesi	750	135,000
9.	Ekonomi dhe Politiko Agrare	750	135,000
10.	Financë -Kontabilitet	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Pyjore			
11.	Mbarëshëm Pyjesh	700	126,000
12.	Përpunim Druri	700	126,000
Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit			
13.	Teknologji Agroushqimore	700	126,000
14.	Vreshtari Enologji	700	126,000
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			
1.	Financë	750	135,000
2.	Administrim-Biznes	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Natyrore			
3.	Biologji	1,700	288,000
Fakulteti Histori - Filologji			
4.	Histori	850	153,000
5.	Gjeografi	850	153,000
6.	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
Fakulteti i Drejtësisë			
7.	Drejtësi	550	99,000
Fakulteti i Shkencave Sociale			
8.	Psikologji	850	153,000
9.	Punë Sociale	850	153,000
Fakulteti i Infermierisë			
10.	Infermieri	1,700	288,000
11.	Mami	1,700	288,000
12.	Teknik Imazherie	1,700	288,000
13.	Teknik Laboratori	1,700	288,000
14.	Fizioterapi	1,700	288,000
Universiteti i Sporteve të Tiranës			
1.	Shkenca të Lëvizjes	1,800	324,000
Universiteti Politeknik			
1.	Inxh. Mek.(Eduk. distance)	1,800	324,000
Universiteti i Gjykostrës			
Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
1.	Cikli i Ulët	850	153,000
2.	Cikli i Ulët Parashkollor	850	153,000
3.	Kontabilitet-Financë	750	135,000
4.	Administrim Publik	750	135,000
5.	Turizëm	750	135,000
6.	Histori-Gjeografi	850	153,000
7.	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
8.	Bio-Kimi	1,700	288,000
9.	Matematikë - Fizikë	600	108,000
Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë			
10.	Financë	750	135,000
11.	Menaxhim	750	135,000
12.	Marketing	750	135,000
13.	Turizëm	750	135,000
14.	Turizëm/ Pogradec	750	135,000
Fakulteti i Mësuësisë			
15.	Cikli i ulët	850	153,000
16.	Cikli i Ulët Parashkollor	850	153,000
17.	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
18.	Infermieri	1,700	288,000
Fakulteti i Bujqësisë			
19.	Agrobiznes	1,100	198,000
20.	Hortikulturë	1,100	198,000
Universiteti i Elbasanit			

1.	Punonjës social	850	153,000
2.	Filozofi-Sociologji	850	153,000
3.	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
4.	Histori-Gjeografi	850	153,000
5.	Edukatë qytetare	850	153,000
6.	Financë-Kontabilitet	750	135,000
7.	Administrim-Biznes	750	135,000
8.	Cikli i Ulët	850	153,000
9.	Cikli i Ulët Parashkollor	850	153,000
10.	Matematikë-Fizikë	600	108,000
11.	Biologji-Kimi	1,700	288,000
12.	Edukim Fizik e Sporte	1,700	288,000
13.	Infermieri	1,700	288,000
14.	Ekonomia dhe e Drejta	750	135,000
15.	Teknologji Informacioni	850	153,000
Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë			
1.	Administrim-Biznes	750	135,000
2.	Financë-Kontabilitet	750	135,000
3.	Turizëm	750	135,000
Fakulteti i Drejtësisë			
4.	Drejtësi	550	99,000
Fakulteti i Shkencave të Edukimit			
5.	Cikli i Ulët	850	153,000
6.	Cikli i Ulët Parashkollor	850	153,000
7.	Edukim Fizik e Sporte	1,800	324,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
8.	Matematikë	600	108,000
9.	Fizikë	600	108,000
10.	Biologji-Kimi	1,700	288,000
Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
11.	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
12.	Histori	850	153,000
13.	Gjeografi	850	153,000
Universiteti i Durrësit Fakulteti i Biznesit			
1.	Administrim-Biznes	750	135,000
2.	Financë-Kontabilitet	750	135,000
3.	Financë-Kontabilitet (fil. Peshk)	750	135,000
Fakulteti i Shkencave Politike- Juridike			
4.	Drejtësi	550	99,000
5.	Drejtësi (fil. Peshk.)	550	99,000
Fakulteti i Edukimit			
6.	Cikli i Ulët	850	153,000
7.	Cikli i Ulët (Fil. Peshk.)	850	153,000
8.	Psikologji-Sociologji	850	153,000
Fakulteti i Studimeve Profesionale			
9.	Infermieri	1,700	288,000
10.	Infermieri (fil. Peshk)	1,700	288,000

TABELA NR.3/1
TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI ME KOHË TË PJESSHME PËR
VITIN AKADEMIK 2010-2011

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për program të dytë	Tarifë totale për program të dytë
Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit			
1.	Hortikulture	1,300	234,000
2.	Mbrojtje Bimësh	1,300	234,000
3.	Prodhim Bimor	1,300	234,000
4.	Zootekni dhe Biznes Blegtoral	1,300	234,000
5.	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	1,300	234,000
6.	Agromjedis dhe Ekologji	1,300	234,000
7.	Agromekanizim	1,300	234,000
Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit			
8.	Menaxhim Agrobiznesi	850	153,000
9.	Ekonomi dhe Politik Agrare	850	153,000
10.	Financë -Kontabilitet	850	153,000
Fakulteti i Shkencave Pyjore			
11.	Mbarëshitim Pyjesh	1,300	234,000
12.	Përpunim Druri	1,300	234,000

Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit			
13.	Teknologji Agroushqimore	1,300	234,000
14.	Vreshtari Enologji	1,300	234,000
Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë			
1.	Financë	1,500	270,000
2.	Administrim-Biznes	1,500	270,000
Fakulteti i Shkencave Natyrore			
3.	Biologji	2,000	360,000
Fakulteti Histori - Filologji			
4.	Histori	1,500	270,000
5.	Gjeografi	1,500	270,000
6.	Gjuhë-Letërsi	1,500	270,000
Fakulteti i Drejtësisë			
7.	Drejtësi	1,500	270,000
Fakulteti i Shkencave Sociale			
8.	Psikologji	1,500	270,000
9.	Punë Sociale	1,500	270,000
Fakulteti i Infermierisë			
10.	Infermieri	2,000	360,000
11.	Mami	2,000	360,000
12.	Teknik Imazherie	2,000	360,000
13.	Teknik Laboratori	2,000	360,000
14.	Fizioterapi	2,000	360,000
Universiteti i Sporteve të Tiranës			
1.	Shkenca të Lëvizjes	2,000	360,000
Universiteti Politeknik			
1.	Inxh. Mek.(Eduk. distance)	2,000	360,000
Universiteti i Gjirokastrës			
Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
1.	Cikli i Ulët	1,100	198,000
2.	Cikli i Ulët Parashkollor	1,100	198,000
3.	Kontabilitet-Financë	1,100	198,000
4.	Administrim Publik	1,100	198,000
5.	Turizëm	1,100	198,000
6.	Histori-Gjeografi	1,100	198,000
7.	Gjuhë-Letërsi	1,100	198,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
8.	Bio- Kimi	2,000	360,000
9.	Matematikë – Fizikë	1,100	198,000
Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë			
1.	Financë	1,100	198,000
2.	Menaxhim	1,100	198,000
3.	Marketing	1,100	198,000
4.	Turizëm	1,100	198,000
5.	Turizëmi Pogradec	1,100	198,000
Fakulteti i Mësuesisë			
6.	Cikli i Ulët	1,100	198,000
7.	Cikli i Ulët Parashkollor	1,100	198,000
8.	Gjuhë-Letërsi	1,100	198,000
9.	Infermieri		
Fakulteti i Bujqësisë			
10.	Agrobiznes	1,100	198,000
11.	Hortikulturë	1,100	198,000
Universiteti i Elbasanit			
1.	Punonjës social	1,100	198,000
2.	Filozofi-Sociologji	1,100	198,000
3.	Gjuhë-Letërsi	1,100	198,000
4.	Histori-Gjeografi	1,100	198,000
5.	Edukatë qytetare	1,100	198,000
6.	Financë-Kontabilitet	1,100	198,000
7.	Administrim-Biznes	1,100	198,000
8.	Cikli i Ulët	1,100	198,000
9.	Cikli i Ulët Parashkollor	1,100	198,000
10.	Matematikë-Fizike	1,100	198,000
11.	Biologji-Kimi	2,000	360,000
12.	Edukim Fizik e Sporte	2,000	360,000
13.	Infermieri	2,000	360,000
14.	Ekonomia dhe e Drejta	1,100	198,000
15.	Teknologji Informacioni	1,100	198,000
Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë			
1.	Administrim-Biznesi	1,100	198,000
2.	Financë-Kontabilitet	1,100	198,000
3.	Turizëm	1,100	198,000
Fakulteti i Drejtësisë			
4.	Drejtësisë	1,100	198,000
Fakulteti i Shkencave të Edukimit			

5.	Cikli i Ulët	1,100	198,000
6.	Cikli i Ulët Parashkollor	1,100	198,000
7.	Edukim fizik e sportiv	2,000	360,000
Fakulteti i Shkencave të Natyrës			
8.	Matematikë	1,100	198,000
9.	Fizikë	1,100	198,000
10.	Infermieri	2,000	360,000
11.	Biologji-Kimi	2,000	360,000
Fakulteti i Shkencave Shoqërore			
12.	Gjuhë-Letërsi	1,100	198,000
13.	Histori	1,100	198,000
14.	Gjeografi	1,100	198,000
Universitetit i Durrësit			
Fakulteti i Biznesit			
1.	Administrim-Biznesi	850	153,000
2.	Financë-Kontabilitet	850	153,000
3.	Financë-Kontabilitet (Fil.Peshk.)	850	153,000
Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike			
4.	Drejtimi	1,100	198,000
5.	Drejtimi (Fil.Peshk)	1,100	198,000
Fakulteti i Edukimit			
6.	Cikli i Ulët	1,100	198,000
7.	Cikli i Ulët (Fil.Peshk)	1,100	198,000
8.	Psikologji-Sociologji	1,100	198,000
Fakulteti i Studimeve Profesionale			
9.	Infermieri	2,000	360,000
10.	Infermieri (Fil.Peshk)	2,000	360,000

VENDIM
Nr.937, datë 17.11.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.424, DATË 2.6.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SISTEMIN E AKREDITIMIT,
ORGANIZIMIN DHE VEPRIMTARINË E INSTITUCIONEVE TË SIGURIMIT TË JASHTËM
TË CILËSISË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 60 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Neni 9 i rregullores “Për sistemin e akreditimit, organizimin dhe veprimtarinë e institucioneve të sigurimit të jashtëm të cilësisë”, që i bashkëlidhet vendimit nr.424, datë 2.6.2010 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 9

Pagesa e anëtarëve të Këshillit të Akreditimit

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Akreditimit të paguhen, për çdo muaj, përkatësisht, me 30 për qind dhe 20 për qind të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm në ministri.”.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 17.12.2010

Doli nga shtypi më 20.12.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë